



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 9.3.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu dhe Driton Çausi.

Mungouan : Sërgjan Mitroviq, Daut Haradinaj, Liburn Aliu, Enver Hoti dhe Salih Salihu.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Besa Gaxherri**, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve;**
3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Veprimtari Hidrometeorologjike;**
4. **Shqyrtimi i strategjisë ujore 2017-2036;**
5. **Formimi i grupeve punuese;**
6. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;

Kryesuesja konstatoi miratimin e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, ndërkaq **Ganimete Musliu** pati vërejtje të përgjithshme që të strukturohen fjalitë më mirë në procesverbale edhe pse janë mirë të kuptueshme, pra të jepet kuptimi i saktë i fjalës së deputetit.

Besa Gaxherri u pajtua me vërejtjen, ngase ndonjëherë po humb qëllimi i deklaramit të deputetit, kurse në procesverbalin e datës 29.1.2018, kërkoi që deklarimi i saj të përmirësohet si vijon : **Deputetja Besa Gaxherri e mori fjalën dhe alarmoi komisionin rreth gjendjes së mjedisit për shkak të ndotjes së ajrit në shkallën jonormale dhe propozoi që komisioni të**

mbajë mbledhje urgjente, për çka komisioni vendosi të mbahet kjo mbledhje më 30 janar 2018, në orën 12:00, ku do të ftohen aktorët kryesorë institucionalë për të diskutuar se çfarë mund të bëjnë për këtë gjendje institucionet tona.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike;

Besa Gaxherri, kryesuese, propozoi që projektligji në fjalë, nëse nuk ka kundër komisioni, të rekomandohet për leximin e parë, pasi që i plotëson kushtet e parapara me rregullore, kurse më pas do të vijon Komisioni me formimin e grupit të punës për leximin e dytë, ndërsa Komisioni nxori këtë :

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim nga mbledhja plenare Projektligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike.

4. Shqyrtimi i strategjisë shtetërore për ujërat në Kosovë 2017-2036

Besa Gaxherri, kryesuese, konstatoi se materiali për këtë pikë është voluminoz, andaj propozoi që të shtyhet për mbledhjen e radhës për një shqyrtim më thelbësor, e ku do të ftohet përfaqësuesi i Qeverisë- Këshillit Ndërmnistror, për sqarime shtesë, me çka u pajtuan edhe anëtarët e Komisionit.

5. Formimi i grupeve punuese

Besa Gaxherri, kryesuese, njoftoi se për dy projektligjet që e kanë kaluar në leximin e parë, duhet të formohen grupet punuese, kurse Komisioni nxori këtë :

P ë r f u n d i m

- I.** Themelohet grupi punues për Projektligjin e trajtimit të ndërtimeve pa leje, në përbërje : **Liburn Aliu,** kryesues, **Andin Hoti dhe Enver Hoti,** anëtarë.
- II.** Themelohet grupi punues për Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore në përbërje : **Driton Çausi,** kryesues, **Ganimete Musliu dhe Danush Ademi,** anëtarë.

6. Të ndryshme.

Kryesuesja, për këtë pikë sugjeroi komisionin të përcaktohen veprimet e mëtejme në lidhje me çështjet si vijon :

- **Intervistimi i 21 kandidatëve** të cilët kanë aplikuar për pozitën e drejtorit të Agjencisë së Komplekseve Memoriale, të caktohet në limitin e paraparë me ligj dhe në afatin

optimal që lejon përgatitjen e duhur. **Komisioni vendosi për datën 19 dhe 20 mars 2018, duke nisur nga ora 10:00**, për shkak se secili kandidat duhet të ketë së paku 15 minuta për të dhënë përgjigje që parashtrihen nga anëtarët e këtij komisioni. Më 19 mars do të intervistohen 10 kandidatë, kurse më 20 mars, do të intervistohen edhe 11 tjerë. (Propozues për këtë vendim ishin, kryesuesja, Ganimete Musliu dhe Lutfi Zharku).

Rreth kërkesës së kryetarit të Komunës Obiliqit për zbatimin e Ligjit për Obiliqin, komisioni sipas propozimit të deputetes **Ganimete Musliu**, u fokusua në tri drejtime : ti drejtohet ministrisë kompetente, të iniciohet pyetja parlamentare përmes mbledhjes plenare ose të formohet grupi punues për monitorim, pse nuk gjen zbatimin ky ligj i miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Danush Ademi konstatoi se institucionet shtetërore duhet të reagojnë edhe për rastin e 15 familjeve në Mitrovicë (lagja 2 Korriku) për shkak të daljes nga shtrati të lumit dhe të vërshimit të shtëpive të këtyre familjeve, gjë që përsëritet çdo vit kur ka reshje të mëdha. Me këtë rast këta familjarë detyrohen ti lëshojnë shtëpitë e tyre.

Ganimete Musliu u angazhua për të vizituar këto familje, por më efikase do të ishte që të drejtohet komisioni ministrisë përkatëse për rregullimin e shtratit të lumit, duke ndarë buxhetin e nevojshëm për këtë intervenim.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e komisionit,

Besa Gaxherri